LIGJ
Nr. 12/2023

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 114, DATË 22.10.2015, "PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 114, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

"7. "Audituesi i brendshëm" është profesionisti, i cili është i certifikuar dhe regjistruar si i tillë, si dhe ka ndjekur trajnimin e vazhdueshëm profesional sipas kërkesave të këtij ligji.".

2. Pika 13 ndryshohet si më poshtë:

"13. "Kodi i Etikës i Audituesit të Brendshëm" është akti administrativ, që miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për financat dhe botohet në Fletoren Zyrtare, në të cilin përcaktohen rregullat e sjelljes dhe parimet që udhëheqin punën e audituesve të brendshëm në sektorin publik në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të miratuara, sipas përcaktimeve të këtij ligji.".

3. Pas pikës 14 shtohet pika 14/1 me këtë përmbajtje:

"14/1. "Keqmenaxhim i rëndë financiar" është veprimi ose mosveprimi i një titullari apo nëpunësi të një njësie publike, që mund të rezultojë ose ka rezultuar me paaftësi paguese financiare të njësisë ose me humbje përtej parashikimeve në buxhetin e miratuar.".

4. Pas pikës 17 shtohet pika 17/1 me këtë përmbajtje:

"17/1. "Parregullsi e rëndë" konsiderohet moszbatimi ose zbatimi i gabuar i ligjeve apo akteve të tjera nënligjore, që e ka origjinën te veprimet ose mosveprimet e përdoruesit të fondeve publike, të cilat kanë ose mund të kenë pasoja të dëmshme për menaxhimin e fondeve publike, pavarësisht nëse ajo prek të ardhurat/të hyrat, shpenzimet/të dalat, fondet e kthyera mbrapsht, aktivin apo detyrimet financiare.".

Neni 2

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime:

a) fjalët "duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm sipas formave të përcaktuara në vijim" zëvendësohen me fjalët "sigurojnë shërbimin e auditimit të brendshëm sipas njërës prej formave të përcaktuara në vijim".

b) Shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:

"b) Kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm nga njësia e Auditimit të Brendshëm e institucionit epror ose nga njësia e Auditimit të Brendshëm e një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse. Marrëveshja miratohet paraprakisht nga ministri përgjegjës për financat.".

c) Shkronja "c" shfuqizohet.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

"2/1. Modeli i marrëveshjes ndërmjet titullarëve të njësive publike, si dhe i kontratës, kur kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm realizohet me kontraktim, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për financat.".

Neni 3

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

a) në shkronjën "a" fjalët "diplomë universitare të nivelit të dytë" zëvendësohen me fjalët "diplomë të arsimit të lartë të ciklit të dytë të studimeve".

b) shkronjat "b", "c" dhe "ç" ndryshohen si më poshtë:

"b) drejtuesi i njësisë së Auditimit të Brendshëm duhet të ketë përvojë pune 5 vjet në profesion, nga të cilat jo më pak se 3 vjet në fushën e auditimit, dhe të jetë i certifikuar si "Audituesi i brendshëm në sektorin publik.";

c) audituesi i brendshëm duhet të ketë përvojë pune jo më pak se 3 vjet në profesion dhe të jetë i certifikuar si "Audituesi i brendshëm në sektorin publik.";

ç) nëpunësi civil ose punonjësi që punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe që nuk zotëron certifikatën si audituesi i brendshëm, gjatë 3 vjetëve të parë punon nën mbikëqyrjen e drejtuesit të njësisë së Auditimit të Brendshëm ose të një audituesi të brendshëm të certifikuar dhe me eksperiencë. Brenda kësaj periudhe, ky punonjës i nënshtrohet detyrimisht procedurës së certifikimit si "Audituesi i brendshëm në sektorin publik". Në rast se brenda këtij afati nëpunësi civil ose punonjësi nuk certifikohet si "Audituesi i brendshëm në sektorin publik", i ndërpriten marrëdhëniet e punës, të cilat konsiderohen që janë ndërprerë për shkak të këtij ligji.".

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Numri i audituesve të brendshëm që kanë diplomë të arsimit të lartë të ciklit të dytë të studimeve në disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që auditohet, sipas shkronjës "a" të pikës 2 të këtij neni, nuk tejkalon një të tretën e numrit të përgjithshëm të audituesve të brendshëm të njësisë përkatëse të Auditimit të Brendshëm.".

Neni 4

Në nenin 12 shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:

"b) krijimin e Komitetit të Auditimit në njësinë publike përkatëse sipas kritereve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës "b" të nenit 23 të këtij ligji.".

Neni 5

Pas nenit 12 shtohet neni 12/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 12/1

Procedura për raportimin e shkeljeve të rënda

1. Titullari i njësisë publike krijon dhe monitoron sistemin e kontrollit të brendshëm, ku përfshihet menaxhimi i riskut të shkeljeve të rënda, keqmenaxhimi i rëndë financiar dhe masat për parandalimin e zbulimin e tyre, si dhe ndërmarrjen e veprimeve kundër rasteve të identifikuara.

2. Kur gjatë auditimit të brendshëm identifikohen tregues të shkeljeve të rënda dhe keqmenaxhimit të rëndë financiar, audituesi i brendshëm ndërpret procedurën e auditimit dhe raporton menjëherë tek drejtuesi i njësisë së Auditimit të Brendshëm.

3. Drejtuesi i njësisë së Auditimit të Brendshëm për çdo rast të raportuar për shkelje të rëndë dhe keqmenaxhim të rëndë financiar në njësinë e audituar i raporton menjëherë me shkrim titullarit të njësisë publike, i cili e dërgon tek ministri përgjegjës për financat që ka në varësi strukturën e inspektimit financiar publik.".

Neni 6

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja "d", pas fjalëve "rekomandimeve të dhëna" shtohen fjalët "nga njësia e auditimit të brendshëm, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe audituesit e jashtëm".

2. Pika 2 shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronja "a" ndryshohet si më poshtë:

"a) organizimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm dhe hartimin e Kartës së Auditimit sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me nenin 8 të këtij ligji.".

2. Shkronja "b" shfuqizohet.

3. Pas shkronjës "c" shtohet shkronja "c/1" me këtë përmbajtje:

"c/1) miratimin e raporteve të angazhimeve të auditimit të brendshëm, pas konsultimit me njësinë publike të audituar për gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet, të cilat i dorëzohen për përdorim të brendshëm titullarit të njësisë publike.".

4.Shkronja "d" shfuqizohet.

Neni 8

Në nenin 16 shkronja "ë" shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 19 pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Nëpunësit civilë dhe punonjës të tjerë, që kanë përvojë pune 3 vjet në profesion apo kryejnë detyra publike ose akademike në disiplina të tilla, si: auditimi i brendshëm, sigurimi i cilësisë, menaxhimi i riskut, inspektimi, përputhshmëria, auditimi i jashtëm dhe kontrolli i brendshëm, kanë të drejtë për të aplikuar për t'u certifikuar si audites të brendshëm në sektorin publik.".

Neni 10

Në nenin 20 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Të gjithë audituesit e certifikuar i nënshtrohen trajnimit të vazhdueshëm profesional, të paktën 80 orë në 2 vjet.".

2. Pas pikës 3 shtohen pikat 3/1 dhe 3/2 me këtë përmbajtje:

"3/1. Në përfundim të çdo kursi trajnimi të vazhdueshëm profesional, audituesi i brendshëm pajiset me vërtetimin e ndjekjes së trajnimit. Vërtetimi depozitohet pranë strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.";

"3/2. Përmbushja e detyrimeve të trajnimit të vazhdueshëm profesional është kusht për regjistrimin e audituesve të brendshëm në Regjistrin Kombëtar të Audituesve të Brendshëm të Certifikuar.".

Neni 11

Në nenin 21 bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm shqyrton dhe i paraqet mendimin e tij ministrit përgjegjës për financat për propozimet e strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, për strategjitë dhe politikat e zhvillimit të audituesve të brendshëm.".

2. Në pikën 2 pas fjalëve “përbërja e Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm” shtohen fjalët “si dhe tarifat e certifikimit dhe të trajnimit të vazhdueshëm profesional”.

Neni 12

Në nenin 22 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1, shkronja “a”, dhe në pikën 2 emërtimi “Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm” zëvendësohet me fjalët “struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm”.

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Forma dhe përmbajtja e Regjistrit Kombëtar të Audituesve të Brendshëm të Certifikuar, të dhënat që mund të bëhen publike, mënyra dhe procedurat e mbajtjes së tyre përcaktohen me urdhër të ministrit të përgjegjës për financat.”.

Neni 13

Në nenin 24 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) zbaton Strategjinë e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik për fushën e auditimit të brendshëm në sektorin publik, si dhe e monitoron këtë veprimtari në nivel kombëtar.”.

2. Në fund të shkronjës “c” shtohen fjalët “si dhe shqyrton paraprakisht çdo propozim që i paraqitet ministrit përgjegjës për financat në lidhje me këto dokumente.”.

3. Shkronja “e” shfuqizohet.

4. Pas shkronjës “g” shtohet shkronja “gj” me këtë përmbajtje:

“gj) krijon dhe mban marrëdhënie me organizatat ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe me struktura homologe përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.”.

Neni 14

Në nenin 25 shkronja “a” e pikës 2 shfuqizohet.

Neni 15

Kudo në përmbajtjen e ligjit emërtimi “Komitet i Auditimit të Brendshëm” zëvendësohet me emërtimin “Komiteti i Auditimit”.

Neni 16

Kudo në përmbajtjen e ligjit emërtimet “Ministri i Financave” dhe “Ministria e Financave” zëvendësohen përkatësisht me fjalët “ministri përgjegjës për financat” dhe “ministria përgjegjëse për financat.”.

Neni 17

Kudo në përmbajtjen e ligjit fjalët “trajnim i vijueshëm profesional” zëvendësohen me fjalët “trajnim i vazhdueshëm profesional”.

Neni 18

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë vendimet në zbatim të nenit 2, pika 2, dhe nenit 4 të këtij ligji.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 2.2.2023.

Shpallur me dekretin nr. 30 datë 15.2.2023, të presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.